VENDIM
Nr. 27, datë 28.2.2019

PËR FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "SANG 1" SHPK NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC "THIRRË" ME FUQI TË INSTALUAR 1820 KW

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2 germa "a" të ligjit nr. 43/2015, *"Për sektorin e energjisë elektrike"*, neneve 4, pika 1, germa "a"; 5, pika 1, germa "a"; 10 pika 1 dhe 3, të *"Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike"*, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.6.2016, dhe nenit 19, pika 1, germa "a", të *"Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s"*, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 28.2.2019, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "SANG 1" sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut mbi fillimin e procedurave për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, të kësaj shoqërie.

Konstatoi se:

Shoqëria "SANG 1" sh.p.k., me shkresën nr. 124 prot., datë 6.2.2019, ka paraqitur kërkesën për t'u pajisur me licencë në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec "Thirrë" me fuqi të instaluar 1820 KW.

Aplikimi i shoqërisë "SANG 1" sh.p.k, i plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në *"Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike"* si më poshtë:

- formati i aplikimit (neni 9, pika 1, germat "a", "b", "c") është plotësuar në mënyrë korrekte;
- dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germat "a", "b", "c", "f") është plotësuar në mënyrë korrekte;
- dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germat "a" dhe "d") është plotësuar në mënyrë korrekte;
- dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.1.1; 4.1.2; 4.1.3 germat "a" dhe "d"; pika 4.1.4, germat "b" dhe "c", "d", "e"; pika 4.1.5 germa "c") është plotësuar në mënyrë korrekte.

Kohëzgjatja e kontratës nr. 2753 Rep; nr. 1403/2 Kol, datë 12.12.2017, "*Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentralit "Thirrë" me kapacitet prodhues 1820 MW, në përroin e Thirrës dhe në degët formuese të tij, ai i Kumbllës, Runjës dhe Qarrit, degë e lumit Fani i Vogël, Bashkia Mirditë, Qarku Lezhë",* do të jetë 49 vjet nga data e hyrjes në fuqi të saj me të drejtë ripërsëritje.

Neni 38, i ligjit nr. 43/2015, *"Për sektorin e energjisë elektrike"*, i ndryshuar, përcakton se: ERE përcakton kushtet që duhet të përmbushen për marrjen e çdo licence, duke marrë në konsideratë, ndër të tjera: a) afatin e vlefshmërisë së licencës, i cili për veprimtaritë e prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes nuk mund të jetë më shumë se 30 vjet;

Në lidhje me mungesën e dokumentacionit të aplikuesit që ka të bëjë me:

- nenin 9, pika 4.1.3, germa "b", "c"; nenin 9, pika 4.1.4, germa "a" (Studimi i fizibilitetit) dhe nenin 9, pika 4.1.5, germat "a" dhe "b" (Miratimi i pikës së lidhjes) dhe (Leja e përdorimit të ujit), do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 11, pika 1, të *"Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike"*, t'i paraqesë këto në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi të ERE-s,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "SANG 1" sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit

të energjisë elektrike nga HEC "Thirrë" me fuqi të instaluar 1820 KW për një afat 30-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
ANËTARE E BORDIT
Erjola Sadushi